



Freie und Hansestadt Hamburg  
Behörde für Schule und Berufsbildung

\_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_  
Schule / Name

## Sprachfeststellungsprüfung Schuljahr 2018/2019

---

### Mittlerer Schulabschluss (MSA) Albanisch

Freitag, 3. Mai 2019, 9:00 Uhr

---

#### **Allgemeine Arbeitshinweise**

- Trage bitte auf diesem Blatt und auf deinen Arbeitspapieren deine **Schule** und deinen **Namen** ein.
- Kennzeichne bitte deine Entwurfsblätter (Kladde) und deine Reinschrift.

#### **Fachspezifische Arbeitshinweise**

- Die Arbeitszeit beträgt 135 Minuten.
  - Erlaubte Hilfsmittel: keine, nur dieser Aufgabensatz
- 

#### **Aufgaben**

- Du erhältst **vier** unterschiedliche Aufgaben.
- Überprüfe anhand der Seitenzahlen, ob du alle Unterlagen vollständig erhalten hast.
- Bearbeite alle **vier** Aufgaben.
- Wenn du möchtest, darfst du die Heftklammer entfernen. Bitte sortiere die Blätter aber vor der Abgabe wieder in die richtige Reihenfolge.
- Schreibe auf **alle Blätter deinen Namen**.

Name: \_\_\_\_\_

## Aufgabe I Leseverstehen

### I. Jugendliche auf Reisen

#### Detyra:

- Lexo mbishkrimet(1-8) dhe më pas textet e përshtatshme (A-E).
- Gjej për çdo pjesë të tekstit bishkrimet e përshtatshme.
- Shkruaj numrin e saktë (1-8) në anën e djathtë të tekstit.
- Numrat mund të përdoren vetëm një herë.
- Tre numra (mbishkrime) mbeten tepër.
- Është dhënë edhe një shembull (0).

#### Mbishkrimet:

<b>0</b>	Të mbledhësh përvojë të rëndësishme për të ardhmen
<b>1</b>	Të ndihmosh si vullnetar njerëzit në vende të tjera
<b>2</b>	Të mësosh shpejt gjuhë të huaja
<b>3</b>	Të marrësh pjesë në takime ndërkombëtare të të rinjve
<b>4</b>	Të organizosh projekte kulturore në një vend tjetër
<b>5</b>	Aktivitete sportive në ajrin e pastër me të tjerët
<b>6</b>	Të përgatitësh qëndrimin jashtë vendit të një familje të huaj
<b>7</b>	Të marrësh pjesë në një program për shkëmbim nxënësish
<b>8</b>	Të fitosh para gjatë udhëtimit

Name: \_\_\_\_\_

<b>Z</b>	Një udhëtim i të rinjve mundëson shumë përvoja dhe të zgjeron horizontin. Këto përvoja të bëjnë ty të fortë si njeri të rrisin vetëbesimin dhe të ndihmojnë ty, që të shpalosësh talentet e tua. Përveç kësaj një udhëtim pa të rriturit ndikon shumë në arritjen e pavaresisë. Njeriu duhet të marrë përsipër detyra të reja dhe të vetvendosë.	<b>0</b>
<b>A</b>	Më në fund jashtë, më në fund i lirë – bota po të pret! Të kujdesesh për pushuesit në Kili, të përkujdesesh për një kopësht me perime në Norvegji, të mbikqyrësh fëmijët në një kamp veror në Angli dhe njëkohësisht të udhëtosh gjatë një viti në vende të huaja – ti mund ta zgjedhësh!  „Work and Travel“ nëpër botë, kjo do të thotë, që ti mund të punosh për një rrogë të vogël ose shpenzime dhe akomodim dhe në ditë të tjera të udhëtosh nëpër vende të ndryshme. Kështu ti mundesh jo vetëm të përjetosh disa aventura, por edhe të njohësh intensivisht vendet dhe njerëzit. Si bëhet? Atëherë, paketo gjërat, jetoje botën dhe bëje vendin tënd të dëshiruar si një shtëpi të dytë!	
<b>B</b>	Ti gjithmonë e ke ëndërruar këtë: të kalosh dy javë me të rinjtë nga vende të ndryshme! Në këtë kohë ti do të mësosh më shumë për kulturën, mentalitetin dhe stilin e jetes së tyre.  Në mbrëmjet ndërkombëtare, ti mëson ushqime tipike të vendeve të ndryshme, muzikë dhe kercime tipike, të vendeve. Ndërkohë ti ke mundësi, që të zbulosh dhe të reflektosh ndryshimet dhe ngjashmërite kulturore. Ti ke kohë të mjaftueshme për të lidhur miqësi!	
<b>C</b>	Ti do që të kalosh një kohë të gjatë jashtë shtetit dhe dëshiron ndërkohë që jo vetëm të udhëtosh por edhe t`i njohësh vendet dhe njerëzit nga afër? Si vullnetare ti futesh më thellë në një kulturë të huaj se sa do të ishte e mundur në një pushim normal. Ti punon si vullnetar krah për krah me vendasit dhe njëkohësisht njeh më mirë kushtet e tyre të jetesës në vendin mikpritës. Ti bën një punë sociale si për shembull mbështet në një shkollë ose në një projekt për ndihmë të fëmijëve. Ti mund edhe të punosh në një projekt Wildlife dhe të japësh pjesën tënde në mbrojtjen e natyrës dhe të kafshëve. Mundësitë për ty janë të shumëllojshme!	
<b>D</b>	Do të doje të shkoje jashtë shtetit, të jetosh aventura të reja, të përmirësosh njohuritë e tua gjuhësore dhe të njohësh vendin e njerëzit? Fatkeqësisht ti nuk ke hapësirë të lirë të mjaftueshme nga shkolla, profesioni ose puna që bën për një qëndrim të gjatë jashtë shtetit. S`ka rëndësi nëse në anglisht, frëngjisht ose spanjisht, se një kurs intensiv gjuhe jashtë shtetit të premtan jo vetëm mësim të suksesshëm, por edhe një udhëtim të paharrueshëm dhe një përvojë të madhe.	
<b>E</b>	Provo lloje të reja të sportit dhe bëhu i guximshëm. Udhëto me shokët e tu me një Mountainbike nëpër natyrën kodrinore, rrëshqit me derrasën e sërfit mbi dallgët, futu me lundër neper ujëra të panjohura ose jetoje shpirtin e ekipit në një ndeshje futbollit ose vollejbolli. Pastaj rehatohu në rërë, që nuk është larg nga vendi i fjetjes. Një ndjenjë e kënaqësisë së plotë! Të jetosh aventurat, të jesh kreativ, të takosh shumë njerëz të moshës tënde, të qeshësh sëbashku dhe thjesht të pushosh – bëje atë, që ty të sjell kënaqësi!	

\_\_\_\_ / 10 P.

Name: \_\_\_\_\_

## Aufgabe II Leseverstehen

### II. Mit dem kostenlosen Interrail-Ticket durch Europa

#### Lexo tekstin dhe kryqëzo në tabelë tek fjalitë (1-6) zgjidhjen e saktë (A, B ose C).

Vanessa është 18 vjece, e lindur në 1999 në një fshat në Sachsen-Anhalt. Deri tani ajo i ka kaluar pushimet vetëm në detin Balltik, në Poloni dhe Ceki. Ajo gjithashtu ka kaluar një udhëtim me klasën në Londër. Tani ajo është në kufirin e Sllovenisë me Kroacinë dhe dëshiron të udhëtojë më tej për në Hungari.

Komisioni Europian i mundësoi asaj këtë udhëtim. Programi quhet „Discover EU“, në kuadrin e të cilit 15.000 të rinj 18-vjecarë nga i gjithë Bashkimi Europian kanë marrë një biletë Interrail falas për gjithë Europën.

Udhëtimi mund të zgjasë deri në 30 ditë. Për fjetjen dhe ushqimin duhet të paguajnë vetë te rinjtë. Pjesëtarët do ta njohin Europën „e vërtetë“, do të njihen me miq nga vende të largëta dhe do të eliminojnë paragjykimet.

Pas dy ditësh, në orën 11 te mbrëmjes, Vanessa është ulur në xhiron e pedonales të Splitit, nën flokët e gjatë ngjyrë kafe dy vathë të mëdhenj, një bluzë me viza, një mushama shiu. Në këtë moment sapo kaloi një rrebesh i fortë sipër qytetit, gjë jonormale për këtë stinë. „Të paktën nuk ka shumë njerëz si zakonisht, nesër këtu do të bëhet e tmerrshme përsëri“, tha Vanessa. Tmerr, kjo do të thotë shumë turistë, që me Selfie-Sticks-at e tyre përmbysin qytetin e vjetër gjatë ditës. Tani disa prej tyre janë ulur në baret pranë pedonales së bregdetit, shumë prej tyre në moshën e Vanessës.

Me trenin e natës do të shkohet në Zagreb, prej andej pastaj për në Hungari.

Udhëtimi me tren, thotë Vanessa, është në të vërtetë gjëja më e bukur në këtë eksperiencë. Të të zejë gjumi në një qytet, të zgjohesh në bregdet, dhe anasjelltas. Midis tyre natyra të ndryshme, biseda me njerëz të ndryshëm, e përditshmja e përbashkët në tren, thuajse si një bashkjetesë në udhëtim.

Në orët e para të mëngjesit arritëm më në fund në Keszthely, Një qytet i vogël pranë liqenit Platten në Hungarinë perëndimore, 21.000 banorë. Bie shi.

Keszthely është saktësisht e kundërta e Splitit: pa jetë nëpër rrugë, dyqane të mbyllura. „thuajse si në vendlindje“, i duket Vanessës. Vendlindja e saj Benndorf është akoma më e vogël, 2000 banorë, dhjetë kilometra larg nga Eisleben, sipas Vanessës në të vërtetë e vogël „e vogël po jo domosdosmërisht e bukur“, megjithatë ajo rikthehet përsëri dhe përsëri atje.

Katër ditë më vonë Vanessa iu bashkua në Budapest një grupi me të rinj të tjerë që udhëtojnë me Interrail. Fillimisht një i ri hollandez. Ata shëtisin nëpër qytet, bisedojnë gjatë mbi Europën, ndryshimet dhe veçoritë e njerëzve në vende të ndryshme dhe mbi atë, që udhëtimet eliminojnë paragjykimet dhe bashkojnë njerëzit. Njëri nga Kölni bën pyetjen fillestare klasike për çdo bisedë udhëtimesh: „nga vjen ti në të vërtetë?“ Vanessa thotë: „Nga Sachsen-Anhalt“. „Ah, ky është një qytet në Sachsen, apo jo?“ Vanessa nuk e di, nëse duhet të qajë apo të qeshë.

Ajo ka ndjenjën pas pjesës më të madhe të udhëtimit, që rinia europiane afrohet nëpërmjet biletës falas Interrail? „Rinia nuk është në të vërtetë problemi“, mendon ajo. Vanessa nuk njeh njeri në moshën e saj, që nuk udhëton me dëshirë në vende të tjera.

Name: \_\_\_\_\_

Njerëzve të rinj ajo u dëshmon një lloj solidariteti bazë, paragjykimet vijnë më vonë. „Kur njerëzit plaken, thonë gjëra të çuditshme.“ Vanessa mendon, „që më mirë të dërgohen njerëzit më të moshuar për në udhetime.“

Quelle: <https://www.jetzt.de/politik/junge-menschen-auf-interrail-trip> (letzter Zugriff: 18.01.2019)

### 1. Vanessa ...

A	Është shoqëruese udhëtimi në një tren për largësitë.	<input type="checkbox"/>
B	Ka qenë në shumë kontinente.	<input type="checkbox"/>
C	Udhëton për herë të parë nëpër Europë.	<input type="checkbox"/>

### 2. Programi „Discover EU“ ...

A	Mundëson udhëtimin për më shumë se 30 ditë.	<input type="checkbox"/>
B	Do të afrojë të rinjtë e Europës.	<input type="checkbox"/>
C	Mundëson udhëtimin me mjete të ndryshme transporti.	<input type="checkbox"/>

### 3. Vanessa kritikon ...

A	Kohën e keqe.	<input type="checkbox"/>
B	Sasinë e turistave.	<input type="checkbox"/>
C	Baret pranë pedonales se bregdetit.	<input type="checkbox"/>

### 4. Mbi të gjitha Vanessa shijon gjatë udhëtimit të saj ...

A	Të udhëtoje me tren në qytete të ndryshme.	<input type="checkbox"/>
B	Të njohë jetën në qytete të panjohura.	<input type="checkbox"/>
C	Të bisedojë me të tjerët për vendlindjen e saj.	<input type="checkbox"/>

### 5. Keszthey në Hungari është për Vanessën ...

a	Si qyteti, ku ajo është rritur.	<input type="checkbox"/>
b	Tipik për qytetet e mëdha të Europës Lindore.	<input type="checkbox"/>
c	Si qyteti, ku ajo ka bërë cdo vit pushime.	<input type="checkbox"/>

### 6. gjatë qëndrimit në Budapest, Vanessa diskuton mbi ...

a	Llojshmëri kulturore të vendeve të ndryshme.	<input type="checkbox"/>
b	Ofertat kulturore në vende të ndryshme.	<input type="checkbox"/>
c	Ofertat e veçanta turistike në qytete të ndryshme.	<input type="checkbox"/>

\_\_\_ / 12 P.

Name: \_\_\_\_\_

## Aufgabe III Sprachmittlung

### III. Berlin erfahren – geführte Radtour

**Në këtë detyrë nuk është e nevojshme një përkthim fjalë për fjalë, por dhënia e informacioneve të rëndësishme në gjuhën e origjinës tënde, në fjali të plotë. Nganjëherë ka disa mundësi për të formuluar një thënie. Vendos ti për një mundësi.**

Një shoqe/ një shok nga vendlinja jote, dëshiron që të udhëtoje për në Gjermani gjatë pushimeve. Ti do që t' i dhurosh asaj/ atij një kartdhuratë për një xhiro me bicikletë nëpër Berlin. Shoqja jote/ shoku yt është i mrekulluar nga kjo ide. Ti e ke gjetur këtë ofertë në një faqe interneti. Jepi shoqes tënde/ shokut tënd informacione në fjali të plotë në gjuhën e origjinës tënde.

### Berlin on Bike !



#### Mit dem Fahrrad durch Berlin

Der beste Weg eine neue Stadt zu entdecken ist das Fahrrad, für Berlin gilt das ganz besonders. Die Stadt ist flach, grün und weitläufig und der Verkehr ist auf Radfahrer eingestellt.

Bei einer geführten Tour lernen Sie Berlin sicher und entspannt in kleinen Gruppen kennen. Unsere gut ausgebildeten Tourguides zeigen Ihnen die schönsten, spannendsten und leckersten Ecken der deutschen Hauptstadt. Mit viel Hintergrundwissen und auch etwas Humor erzählen wir Ihnen von den besonderen Höhepunkten unserer Heimatstadt. Als Radfahrer sind Sie ganz nah dran an Berlins berühmten Sehenswürdigkeiten.

Das Tempo ist dabei entspannt und auch für untrainierte Radfahrer leicht zu bewältigen. Und damit Sie beim Fahren noch schauen können, führen wir Sie über gut ausgebaute Radwege oder durch ruhige Nebenstraßen.

Von der klassischen Sightseeing-Runde entlang der wichtigsten Sehenswürdigkeiten oder der Berliner Mauer, über Touren ins alternative Kreuzberg bis hin zu Spezialtouren zu Themen wie Berlins Street Art oder in den wilden Osten. Entdecken Sie vom Rad aus mit uns gemeinsam eine der aufregendsten Städte der Welt!

Während der Saison von Mitte März bis Anfang November finden täglich Touren statt. Unser Depot, Fahrradverleih und Büro sind Montag bis Sonntag von 8:00 bis 20:00 Uhr für Sie geöffnet.

Name: \_\_\_\_\_

Unser Fahrradparkhaus besteht aus mehreren hundert gut gewarteten und verkehrssicheren Bikes verschiedenster Typen. Wir haben garantiert das richtige Rad für Sie und genug Platz um eine Proberunde auf dem Hof zu drehen. Auch wenn jemand z.B. aus gesundheitlichen Gründen nicht Rad fahren kann, muss niemand zurückbleiben. Für solche Fälle arbeiten wir mit einer Reihe von Fahrrad-Taxis zusammen, die auf Anfrage gebucht werden können.

### **Service rund ums Fahrrad und Tour**

Neben gut gewarteten Rädern bekommen Sie bei uns auch diverses Zubehör, um Ihre Reise so angenehm wie möglich zu machen. Helme, Ponchos, Hosenträger, Sonnencreme und Handschuhe gibt es bei uns jederzeit kostenfrei. Tipps zu kulturellen Veranstaltungen, Unterkünften, den besten Hotels und Ausflügen bekommen Sie nicht nur bei uns vor Ort, sondern auch regelmäßig bei uns im Blog. Hier und auf unserer Webseite informieren wir Sie auch regelmäßig über die besten Veranstaltungen.

Quelle: Nach <https://berlinonbike.de/> (letzter Zugriff: 13.01.2019)

**1. Shpjego, përse pikërisht biçikleta është e përshtatshme për një xhiro nëpër Berlin. Shkruaj dy shembuj.**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\_\_\_\_/ 2 P.

**2. Përmend dy përfitime nga një xhiro, që bëhet me biçikletë.**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\_\_\_\_/ 2 P.

**3. Shpjego, çfarë rrugësh do të përdoren. Shkruaj dy shembuj.**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\_\_\_\_/ 2 P.

**4. Kur bëhen xhirot e stinës?**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\_\_\_\_/ 1 P.

Name: \_\_\_\_\_

---

**5. Përshkruaje gjendjen e biçikletave, që mund të merren me qera.**

---

\_\_\_\_/ 1 P.

**6. Shpjego, çfarë duhet të bëjnë klientët, për të gjetur biçikletën e duhur.**

---

\_\_\_\_/ 1 P.

**7. Përmend një ofertë alternative, që qeradhënësi bën për ata klientë, që nuk janë në gjendje të ngasin vetë biçikletën.**

---

\_\_\_\_/ 1 P.

**8. Përmend tre gjëra, që janë falas kur merr me qera.**

---

---

---

\_\_\_\_/ 3 P.

**9. Për cilat informacione mund të marrësh këshilla nga ofruesi në Internet? Përmend tre shembuj.**

---

---

---

\_\_\_\_/ 3 P.

\_\_\_\_ / 16 P.



Name: \_\_\_\_\_

## Aufgabe IV Textproduktion

### IV. Sommerakademie

Çdo vit të rinjtë kanë mundësinë, të marrin pjesë në një akademi vere. Në këtë kohë ata mund të përmirësojnë njohuritë e tyre gjuhësore dhe të përgatiten për të ardhmen e tyre. Në këto tre javë të rinjtë mund të shpalosin kreativitetin dhe forcën e tyre individuale.

Pranë kurseve gjuhësore pjesëtarët dhe pjesëtarët përshkojnë një program të larmishëm, që përveç të tjerave përmban edhe trajnime për aplikim pune dhe aktivitete të ndryshme sportive. Në përfundim të akademisë verore të rinjve u jepet një certifikatë, ku vlerësohen arritjet personale si edhe angazhimi i tyre dhe u mundëson një përparësi për aplikim për punë.

**Ti ke marrë pjesë në një akademi verore dhe tregon për këtë përvojë në një blog. Ki parasysh aspektet, që vijojnë:**

- Shpjego, përse ti ke marrë pjesë në akademinë verore.
- Përshkruaj programin trejavor të akademisë verore.
- Shpjego, përse ty të kanë pelqyer shumë disa nga përvojat e tua.
- Përshkruaj disa probleme, që u shfaqen.
- Shkruaj mendimin tënd përfundimtar për akademinë verore.

Shkruaj midis **200** dhe **250** fjalësh.

Blog per mesimin - DaZ

Shkruar nga:

Datë: 03.05.2019 10:30

---

---

---

---

---

---

---

---







Name: \_\_\_\_\_

## Bewertungsbogen

<b>Aufgabenteil</b>		<b>maximale Punkte</b>	<b>erreichte Punkte</b>
<b>Leseverstehen</b>	Aufgabe 1	<b>10</b>	
	Aufgabe 2	<b>12</b>	
<b>Sprachmittlung</b>		<b>16</b>	
<b>Textproduktion</b>	Inhalt	<b>12</b>	
	Sprache	<b>18</b>	
	Gesamt	<b>30</b>	
<b>Gesamtpunktzahl</b>		<b>68</b>	

<b>Note (schriftlich)</b> <b>1. Fachprüfer/in</b>	
<b>Note (schriftlich)</b> <b>2. Fachprüfer/in</b>	

Note: \_\_\_\_\_

Datum: \_\_\_\_\_

Unterschrift 1. Fachprüferin/Fachprüfer: \_\_\_\_\_

Unterschrift 2. Fachprüferin/ Fachprüfer: \_\_\_\_\_